

1 E mërkurë, 19 nëntor 2025

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

5 [I akuzuari Krasniqi hyn në sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 14.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,
8 paraqisni lëndën, ju lutem.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
14 procesverbal, konstatoj se z. Krasniqi është i pranishëm në
15 Gjykatë me neve. Ndërsa z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi hoqën
16 dorë nga e drejta e tyre për të qenë të pranishëm në sallë të
17 gjyqit dhe marrin pjesë përmes videolidhjes.

18 Përpara se të fillojmë me axhendën e Konferencës për
19 Ecurinë e Çështjes, kemi disa çështje paraprake që Trupi
20 Gjykues dëshiron të trajtojë.

21 Së pari, Trupi Gjykues dëshiron të trajtojë -- rikujton
22 se në seancën e djeshme ZPS-ja paraqiti për pranim dy
23 dokumente, SPOE00405847 deri në 00405880 dhe DHT10293 deri në
24 DHT10336, të cilët Trupi Gjykues -- të cilëve Trupi Gjykues iu
25 dha një numër provizor si MFI, pra, P04515 dhe P0440516,

1 përkatësisht. Mbrojtja e Thaçit kundërshtoi pranimin e tyre
2 duke argumentuar se dokumentet janë deklarata me shkrim të
3 dhëna nga Dëshmitari 1DW-007 në cilësinë e dëshmitarit, nën
4 betim, përpara Komisionit për Çështje Ushtarake në Senatin e
5 Shteteve të Bashkuara, dhe si të tilla, ato janë provat e
6 marra nga dëshmitari dhe që janë dhënë në lidhje me procedura
7 në një proces ligjor. ZPS-ja u kundërpërgjigj se provat
8 provizore në fjalë nuk janë në përputhje dhe u nënshtrohen
9 rregullave 153, 155 dhe për rrjedhojë -- meqenëse pasi ato
10 janë deklaratat që janë -- nuk janë marrë si pjesë e një
11 procesi penal apo civil.

12 Kjo është në faqen 14, 15 dhe 56, 58 të transkriptit në
13 kohë reale të ditës së djeshme.

14 Siç është përsëritur dhe më herët nga ky Trup Gjykses dhe
15 theksuar, rregullat 153, 155 janë *leges speciales*, pra ligje
16 të veçanta lidhur me provat që vijnë brenda fushëveprimit të
17 nocionit të deklaratës me shkrim të dhënë nga një dëshmitar;
18 shih, për shembull, F01852, paragrafi 10. Në rastet kur provat
19 e propozuara përmbushin kriteret e deklaratës, ato mund të
20 ofrohen në përputhje me njërin prej këtyre rregullave për të
21 siguruar se palët nuk mund të anashkalojnë garancitë e veçanta
22 në fuqi për pranimin e dëshmisë e provave të dëshmitarit.
23 Trupi Gjykses vëren se rregullat 153, 155, nuk kufizohen në
24 fushëveprimin e tyre në deklaratat me shkrim të dhëna nga
25 dëshmitari në kontekstin e një hetimi penal apo të procesit

1 penal. Për këtë qëllim -- për qëllim dhe nevoja të rregullave
2 153, 155 mjafton që deklaratat në fjalë të jetë provë e marrë
3 nga dëshmitari dhe të jetë dhënë në lidhje me një proces
4 ligjor. Lidhur me këtë, Trupi Gjykses udhëzon palët -- iu
5 kujton palëve urdhrin e tij gojor të datës 23 shtator 2025.

6 Në këtë rast, provat materiale të propozuara nuk përbëjnë
7 deklaratat me shkrim të një dëshmitari në kontekstin e
8 procedurës ligjore. Të dy provat provizore janë transkripte të
9 seancave të -- përballë komisionit të shërbimeve ushtarake të
10 Senatit të Shteteve të Bashkuara. Trupi Gjykses vlerëson se
11 seancat përpara komisioneve të Shteteve -- të Senatit të
12 Shteteve të Bashkuara, sikurse ai që është përshkruar në
13 provat provizore në fjalë, nuk janë proceduara ligjore në
14 përputhje -- që përputhen me rregullën 153, 155 sepse nuk kanë
15 për synim që të zgjidhin ndonjë kontest ligjor përmes një
16 procesi gjyqësor. Fakti që deklaratat mund të jenë apo mund të
17 mos të jenë dhënë nën betim, nuk është thelbësore në këtë
18 çështje. Kemi gjithashtu tregues se këto deklaratat janë marrë
19 në -- duke ditur që do të ketë procedurë ligjore, qoftë civile
20 -- qoftë civile apo penale.

21 Trupi Gjykses vë në dukje se më herët ka pranuar në prova
22 sipas rregullës 138 të dhëna të ngjashme nga seanca dëgjimore
23 të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Senatit të Shteteve
24 të Bashkuara që janë paraqitur nga të dy palët, ZPS-ja dhe
25 Mbrojtja e Thaçit. Këto janë P00942 dhe 1D00290.

1 Për arsyet e përshkuara më lartë, Trupi Gjykues konstaton
2 se provat me numër provizor P04515 dhe P04516 nuk janë të
3 ndryshme nga ato që janë pranuar më herët. Kjo qasje është
4 tërësisht në përputhje me atë të juridiksioneve të tjera me
5 sisteme të tjera të krahasueshme për pranimin e provave. Për
6 shembull, në rastin Karadzic përpara TPNJ-së, deklaratat e
7 ndryshme të dhëna në Parlament janë pranuar si prova në atë
8 çështje.

9 Për rrjedhojë, Trupi Gjykues konstaton se provat
10 provizore P04515 dhe P04516 nuk janë, nuk përfshihen nga
11 përkufizimi i deklaratave të dhëna brenda kuptimit të
12 rregullave 153 deri në 155. Trupi Gjykues konstaton gjithashtu
13 se P04515 dhe P04516 përmbushin kriteret për pranim sipas
14 rregullës 138. Për rrjedhojë ato pranohen.

15 Me këtë përfundon urdhri i parë i Trupit Gjykues.

16 Së dyti, me 8 shtator 2025, ZPS-ja kërkoi që Trupi
17 Gjykues të konsolidojë provat materiale të Prokurorisë P0074,
18 P00507, P01634 dhe P02619, të cilat janë pjesë të U00-4844
19 deri në U000-4859, dhe të bëhet një provë e vetme materiale.

20 ZPS-ja dha një përshkrim -- sqaroi që ishin angazhuar në
21 shkëmbime *inter partes* me Mbrojtjen dhe që nuk kishte
22 kundërshtime për këtë propozim që, pra, të gjitha faqet e
23 U000-4844 deri në U000-4859 të përfshihen në një provë
24 materiale të konsoliduar të përbashkët, përfshirë edhe ato që
25 nuk ishin pranuar më herët.

1 A mund të konfirmoj që nuk ka kundërshtime që këto faqe,
2 pra, U000-4844 deri në U000-4859 të pranohen në prova?

3 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime. Ka qenë
4 propozimi jonë që të përfshihen të gjitha faqet në këtë provë
5 materiale dhe presim që të pranohet nga të gjitha palët ashtu
6 siç u urdhëruar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 z. Dixon.

9 Mbrojtja e Viktimave, ndonjë kundërshtim?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pasi dëgjuam
12 palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses pranon në prova faqet
13 U000-4844 deri në U000-4959 që nuk janë pranuar më herët në
14 prova dhe përkthimet e tyre përkatëse dhe udhëzon Zyrën
15 Administrative të bashkojë P00074, P00507, P01634 dhe P02619,
16 dhe faqet shtesë që sapo u pranuan në provën materiale të
17 konsoliduar, përkatësisht, P00074.

18 Me këtë përfundon urdhri i dytë gojor.

19 Tani do të vazhdojmë me axhendën për Konferencën për
20 Ecurinë e Çështjes. Trupi Gjykses ka caktuar këtë konferencë
21 me qëllim që të lehtësojë përmbylljen e paraqitjes së -- e
22 procesit të paraqitjes së provave.

23 Trupi Gjykses dëshiron të diskutojë pikat në vijim:
24 Procesi i zhdëmtimit, mbyllja dhe përfundimi i paraqitjes së
25 provave të Mbrojtjes, paraqitja e kudërprovave të Prokurorisë,

1 e kundërprovave të Mbrojtjes, dhe në fund paraqitja e dosjes
2 përfundimtare dhe fjalës përfundimtare, argumentet
3 përfundimtare.

4 Lidhur me pikën e parë në axhendë, dhe kjo është si
5 diskutim. Pra, nuk synoj që të jem unë i vetmi që flas këtu.
6 Dua të dëgjon mendimet e të gjithëve lidhur me këto pika. Do
7 të marrim një vendim, shpresoj këtë javë pas seancës së sotme.

8 Së pari, lidhur me pikën e parë në axhendë, Trupi Gjykses
9 konstaton se palët dhe pjesëmarrësit kanë paraqitur
10 parashtrimet e tyre lidhur me modalitetet e zhdëmtimit, për
11 procesin e zhdëmtimit të hënën, 17 nëntor 2025.

12 Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka dhënë informacion,
13 ka treguar e përgjigjen e tyre se parashtrimi F03582, në
14 parashtrimin që po parashtron, pra, do të dëgjojë --
15 parashtron F03582 që është në dispozicion dhe ajo është në
16 dispozicion, pra, ZPS-ja për të bërë parashtrime lidhur me
17 këtë që: Numri një, nëse Trupi Gjykses do të udhëzojë viktimat
18 që të ngrenë padi civile në Kosovë në përputhje me nenet 22(9)
19 dhe 167, apo që të nxjerrë një urdhër për zhdëmtim në pajtim
20 me nenin 22; dhe pika dy, koha që i nevojitet ZPS-së për t'ju
21 përgjigjur kërkesës për zhdëmtim të paraqitur nga Mbrojtësi i
22 Viktimave.

23 Lidhur me kalendarin, pra, që vlerësohet i duhur nga
24 Trupi Gjykses, Prokuror a jeni gati që të bëni këto
25 parashtrime sot?

1 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar. Ne mund të jemi të
2 shkurtër. Mbështesim parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave,
3 dhe ato janë në F03583, lidhur me udhëzimin e viktimave që të
4 ngrenë padi civile në Kosovë dhe arsyet janë ato që janë
5 shprehur dhe përshkruar në parashtrimet e Mbrojtësit të
6 Viktimave, kryesisht çështja e masave mbrojtëse gjithashtu dhe
7 çështja e vendndodhjes së viktimave në këtë çështje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, ndoshta mendoj që
10 harrova pjesën e dytë të pyetjes tuaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Pyetja
12 ishte: Kur ZPS-ja mendon që mund të përgjigjet me qëllim që
13 Gjykatësit të vendosin lidhur me këtë çështje.

14 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon pyetjes, pra, tuaj,
15 mendojmë që do të kërkojmë të njëjtin afat kohor që i është
16 dhënë edhe Mbrojtjes për të njëjtën pikë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Trupi Gjykses tani fton Mbrojtjen që të bëjë parashtrime
19 lidhur me faktin nëse Trupi Gjykses duhet të udhëzojë viktimat
20 të ngrenë padi civile në Kosovë në përputhje me nenet që u
21 përmendën më herë, apo çështjen e urdhrit për zhdëmtim në
22 përputhje me nenin 44.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Në emër të Mbrojtjes, siç është
24 përshkuar në parashtrimet që kemi bërë, ne parashtrojmë se
25 është e hershme që të bëjmë këto paraqitje tani dhe këto

1 parashtrime tani. Pajtohem me Mbrojtësin e Viktimave se
2 zhdëmtimi duhet të bëhet pas aktgjykimit dhe nuk mund të --
3 dhe mund të përcaktohet më mirë siç e ka bërë z. Laws në
4 parashtrimin e tij. Ne nuk e dimë cilat janë konstatimet e
5 bëra, cilat viktima mund të përshkruhen, e kështu me radhë.
6 Mund të duhet pak kohë për të bërë këto parashtrime, pra,
7 parashtrimi jonë është që të presim derisa kjo të bëhet që të
8 jetë koha e duhur.

9 Por, mendoj që trajtojmë çështje që mund të trajtohen në
10 një kohë të mëvonshme. Ne mendojmë që kjo mund të na kërkohet
11 të bëhet në kohën e duhur.

12 Kërkojmë për katër javë që t'u përgjigjemi kërkesave të
13 parashtruara dhe parashtrimeve të bëra lidhur me zhdëmtimin e
14 viktimave, dhe do të themi katër javë pas aktgjykimit. Z. Laws
15 ka propozuar katër javë, dhe ne kërkojmë katër javë të tjera
16 shtesë për t'u përgjigjur pas aktgjykimit, kur të kemi të
17 ditur se cilat janë konstatimet e bëra.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush
19 tjetër?

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Thjesht desha të shtoj se ne
21 kuptojmë nga parashtrimi F3583 se njëra prej pikave kyçe do të
22 jetë disponueshmëria e masave mbrojtëse në procedurat vendore,
23 pra, kombëtare. Thjesht nuk jam në gjendje tani që të ndihmoj
24 lidhur me hollësitë e kësaj çështje. Duke konstatuar në
25 çështjen Shala, mendoj ka qenë parashtrimi 310, kjo është

1 trajtuar mbi bazën e dëshmive të ekspertëve, ekspertiza të
2 disponueshme në këtë çështje dhe ndjekim të njëjtin model,
3 pra. Duhet që t'i shohim më në hollësi këto në mënyrë që të
4 ndihmojmë më tej.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. LAWS: [Përkthim] Në qoftë se mund t'i përgjigjem z.
7 Dixon, ju lutem, shkurtimisht. Dy pika.

8 Pikësëpari, ne parashtrojmë që nuk do të jetë kurrë në
9 asnjë moment momenti i duhur për të udhëzuar ndonjë prej
10 viktimave në këtë çështje që të ngrenë padi civile në Kosovë
11 dhe, pra, duhet që të pritët rezultati i këtyre gjërave nuk
12 është relevant -- nuk është një element relevant për t'u marrë
13 parasysh në këtë. Ne kemi përshkruar të gjitha arsyet se pse
14 nuk është e përshtatshme dhe e duhur dhe këto argumentet që
15 paraqitur janë të vlefshme në çdo fazë të kësaj procedurë.

16 Së dyti, do të doja të thoja që vendimi duhet të merret
17 tani, viktimat kanë nevojë të dinë se cila është e ardhmja e
18 tyre. Duhet t'ju jepet mundësia të presin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

20 Z. DIXON: [Përkthim] Në qoftë se mund të përgjigjem
21 shkurtimisht. Ky është një vendim tërësisht abstrakt që do të
22 merret. Me gjithë respektin që kam, viktimat nuk kanë nevojë
23 ta dinë tani këtë gjë. Ata duhet të presin deri ditën e
24 aktgjyqimit, pra, pastaj veprimet e mëtejshme mund të
25 shqyrtohen në kohën e duhur në përputhje me parashtrimet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
2 a ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë?

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës,
4 Smith.

5 Z. Laws, kam tre pika që do të doja t'i ngre me ju.

6 Në parashtrimin e protokolluar, paragrafi 23, ju i
7 referoheni tre aktekspertizave nga Dr. Lerz, të cilat ju i
8 përmendët në paragrafin 7.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, janë, ekzistojnë tre
11 aktekspertiza që ju i keni parashtruar, dorëzuar.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Kështu është, e saktë.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pse keni nevojë për dy javë
14 që t'i parashtroni ato? Ne e dimë përmbajtjen e tyre.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Përgjigja e drejtpërdrejtë lidhur me
16 këtë çështje, forma e paraqitjes së tyre do të jetë pak më
17 ndryshme. Ne duam ta ndryshojmë atë dhe duam që të na jepet
18 mundësia thjesht për t'u siguruar që ato janë në përputhje me
19 konstatimet faktike në aktgjykim.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pika ime e dytë ka të bëjë
21 me propozimin për të angazhuar një ekspert për të raportuar
22 lidhur me format e mundshme të zhdëmtimit kolektiv.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe ju thoni në parashtrimin
25 tuaj që bazohet në aktepskertizën. Ju keni patur diskutime,

1 bisedime paraprake me ekspertët përkatës.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani unë dua t'ju pyes për
4 diçka, dhe viktimat, pra, tuaja, natyrisht, do të jenë në
5 gjendje që të shprehen -- t'ju shprehin juve preferencat e
6 tyre që mund të kenë, individuale, krahasuar me zhdëmtimin
7 kolektiv, për çfarë lloj zhdëmtimi kolektiv bëhet fjalë në
8 qoftë se do të -- aktgjykimi do të shpallë të akuzuarit
9 fajtorë. Ju dhe ekipi jua jeni gjithë ekspertizën që ju duhet
10 për t'i bërë parashtime Gjykatës ku pasqyrohen preferencat e
11 viktimave.

12 Pra, pyetja ime lidhur me këtë është: Çfarë fitoni, cila
13 është vlera e shtuar në qoftë se një dëshmitar -- që një
14 dëshmitar tjetër ekspert, pra, sjellin, ose prania e tij?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk ka të bëjë shumë -- aq shumë me
16 vlerën e çfarë mund t'i shtohet apo çfarë mund t'i jepet më
17 tej Gjykatës për të kuptuar përmes një mendimi ekspert, dhe
18 nuk bëhet fjalë -- nuk është zhdëmtimi kolektiv apo zhdëmtimi
19 individual është diçka shtesë për materialet.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Nuk ka përkthim].

21 Z. LAWS: [Përkthim] Po, dhe ne e shohim -- e kuptoj pikën
22 tuaj, i nderuar Gjykatës, por në përgjithësi kur flasim, kur
23 bëhet fjalë për një propozim të tillë që bëhet, ndoshta ka më
24 shumë autoritet kur vjen nga një ekspert sesa nga një avokat.
25 Ndoshta duhet të presim dhe të shohim çfarë del nga ky

1 propozim.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull.

3 Pika përfundimtare është se dëshmia e ekspertit, që ju
4 thoni në paragrafin 26, është e kufizuar në aktekspertizën e
5 Lerz, plus ky raport për të cilin po flasim --

6 Z. LAWS: [Përkthim] Po .

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] -- kolektive --

8 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të qartësoj nëse doni të
10 parashtroni dëshmi joeksperte të ndonjë natyre?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Po merremi me këtë mundësi, I nderuar
12 Gjykatës, në qoftë se më jepni një çast. Po merremi me
13 mundësinë e paraqitjes së parashtrimit të provave nga vetë
14 viktimat, vartësisht nga rezultati i kërkesës për marrje
15 parasysh të pjesshme të cilën ne e kemi parashtruar sipas
16 rregullës 153 -- me kërkesën sipas rregullës 153. Dhe ne duhet
17 të presim se çfarë vendoset lidhur me këtë kërkesë dhe pastaj
18 të rishqyrtojmë nëse ka diçka për të parashtruar më tej përveç
19 dëshmisë jo -- si dëshmi joeksperte në formën e paraqitur,
20 pra, si nga vetë viktimat, dhe kjo është në paragrafin 25 të
21 parashtrimit tonë me titullin "Materialet e tjera".

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptoj. Dhe në fund, është
23 përmendur në parashtrimet dhe të Mbrojtjes nga ju -- të
24 Mbrojtjes dhe nga ju, vështirësia e paraqitjes së
25 parashtrimeve kur ju nuk e dini se a do të ketë aktgjykim me

1 dënim, pra, a do të shpallen fajtorë --

2 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] -- lidhur me viktimat.

4 Pyetje: A pajtoheni se ka, duke folur gjerësisht, parashtime
5 që mund të bëhen në bazë të supozimit teorik se mund të ketë
6 shpallje fajtor, edhe pse nuk mund të bëni parashtime të
7 hollësishme dhe shumë konkrete? Pajtoheni me këtë?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Ne duhet të bëjmë parashtime që
9 mbulojnë çdo konstatim faktik që mund të dalë me qëllim që të
10 bëjmë parashtime të njëmendta. Po, këto parashtime mund të
11 bëhen në teori, por në praktikë është -- do të ishte një punë
12 shumë e madhe për të shikuar dhe analizuar përgjegjësinë e
13 secilit të akuzuar, me të gjitha vendet e ndryshme, vendet e
14 ndalimit individual apo familjet prekura nga vrasja, dhe të
15 përpiqemi të themi për secilin vend cili do të jetë rezultati.
16 Ne e konsiderojmë këtë si diçka që nuk do të jemi në gjendje
17 ta bëjmë në mënyrë që do të ishte e dobishme për Trupin
18 Gjykues.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, një
21 diçka tjetër. Ju thatë se nuk besoni që do të jetë e mundur që
22 të bëni referimin tek autoritet civile në Kosovë.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
25 thoni pse, për çfarë arsye, dhe mund të kalojmë në seancë

1 private në qoftë se keni nevojë, në qoftë se ka diçka të
2 ndjeshme lidhur me këtë. Por thjesht do të doja të kisha
3 arsyetimin tuaj në procesverbal.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit për mundësinë që më
5 dhatë. Ne kemi paraqitur parashtrime të hollësishme lidhur me
6 këtë temë dhe parashtrimi ynë varet pothuajse plotësisht nga
7 konstatimet e Trupit Gjykues I, i cili e shqyrtoi pikërisht
8 këtë çështje, qoftë në çështjen Mustafa ashtu dhe Shala. Dhe
9 ata udhëzuan tre ekspertë që kishin ekspertizën e duhur lidhur
10 me procesin civil në Kosovë për të vlerësuar një referim i
11 tillë do të ishte praktik. Dhe rezultati ishte mjaft i qartë.
12 Dhe ne e trajtojmë në paragrafin 13 të parashtrimeve tona,
13 duke cituar më gjerë sesa mund të përsëris unë këtu. Analizën
14 e Trupit Gjykues I lidhur me pozicionin e tij, në lidhje me
15 disponueshmërinë e anonimitetit të viktimave në proceset
16 civile në Kosovë. Dhe titulli i asaj teme është që procedurat
17 civile në Kosovë nuk ofrojnë anonimitet dhe si rrjedhojë
18 viktimat përkatëse në atë proces do të duhej të bënin të ditur
19 identitetin e tyre dhe kjo do të përfshinte gjithë
20 vështirësitë përkatëse.

21 Pra, përfundimi i tyre, dhe po e lexoj meqenëse kam
22 fjalën, është në paragrafin 14, tonin:

23 "Duke patur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues mendon se
24 nuk do të ishte me vend që t'i dërgonim viktimën në gjykatën
25 civile sipas nenit 22(19) [Sipas përkthimit] të ligjit dhe

1 rregullën 68 të Rregullores.”

2 Ky ishte përfundimi i tyre.

3 Në fakt çështja shkon më tej se atë, sepse vetëm
4 anonimiteti do të mjaftonte për ta trajtuar këtë çështje në të
5 dy rastet. Ekspertët vunë në dukje më tej vështirësi të tjera
6 lidhur me mënyrën se si viktimat që kërkojnë drejtësi në
7 gjykatën civile të Kosovës dhe kjo do të përfshinte, siç kemi
8 thënë në paragrafin 18:

9 “Gjasat e mëdha për korrupsion dhe ndërhyrje në sistemin
10 ligjor në Kosovë; probleme lidhur me ekzekutimin e vendimeve
11 të Gjykatave përkundrejt aseteve që ndodhen në vende ku nuk ka
12 -- me të cilat nuk ka lidhje diplomatike apo marrëveshje
13 juridike me Kosovën; fakti që ekzistojnë burime financiare
14 mund të mos jenë të mjaftueshme; dhe së fundi, pasigurinë
15 lidhur me kërkesën e parashkrimit lidhur me kërkesat civile të
16 paraqitura nga viktimat e luftës.

17 Këto i kanë thënë ekspertët Trupit Gjykses I, dhe ne
18 parashtrojmë se përveç anonimitetit që do të mjaftonte për
19 mendimin tonë për t'i dhënë fund debatit, është një tipar
20 mjaft i rëndësishëm për ta pasur parasysh.

21 Dallimi kryesor lidhur me këtë çështje dhe çështjet
22 Mustafa dhe Shala është demografia e viktimave, në veçanti një
23 numër i madh viktimash në këtë rast nuk jetojnë më në Kosovë,
24 si edhe të gjitha pengesat e tjera shtesë të cilat ne i kemi
25 shqyrtuar dhe i ka identifikuar dhe eksperti dhe lidhur me ato

1 viktimat, dhe ne parashtrojmë se është e pamundur se si mund të
2 presësh prej tyre të kenë qasje në drejtësi në Kosovë.

3 Por kjo është -- ky është një argument shtesë, nuk është
4 argumenti kryesor, por lidhet me një numër të madh viktimash
5 përkatëse, kështu që po ja u themi. Iu përgjigja pyetjes tuaj?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Ishte
7 mjaft me dobi.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kemi nevojë për dëshmi ekspertësh
9 për t'iu përgjigjur, sepse ideja që juridiksioni kombëtar --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Janë të
11 njëjtat çështje.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Po mund të jetë një perspektivë
13 tjetër kjo, që mbase sistemi e lejon.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të ishte
15 -- ja vlente një argument, por nuk e di.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Asnjë juridiksion, mendoj, nuk lejon
17 që të paraqitet një çështje e tillë. Kjo mënyrë në çdo
18 juridiksion kombëtar, ka mënyra për të trajtuar çështje të
19 tilla dhe mendoj që është e padrejtë që të thuash që gjithë
20 sistemi është i korruptuar dhe i padrejtë. Për këtë do të
21 duheshin prova.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E the atë që
23 deshe të thuash tre herë.

24 Z. LAWS: [Përkthim] A mund t'i përgjigjem?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. LAWS: [Përkthim] Ne nuk po flasim për një krahasim të
2 juridiksionit të Kosovës dhe të vendeve të tjera që mund të
3 kenë ose jo fushëveprim për anonimitet. Ne po flasim për
4 Kosovën dhe këtë Gjykatë e cila ka të drejtë të mbrojë
5 anonimitetin e viktimave. Pra krahasimi është pa vend
6 krejtësisht.

7 Unë theksoj se ato që kam lexuar nuk është opinioni i
8 Trupit Gjykues I apo imi, është opinioni i ekspertit të
9 pavarur që është udhëzuar ta shikojë, ta shqyrtojë këtë
10 çështje jo një, por tre dhe ishte përfundimi që u arrit prej
11 tij.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 çështje tjetër që palët dhe pjesëmarrësit do të donin të
14 ngrinin lidhur me procedurat e zhdëmtimeve? Asgjë.
15 Faleminderit.

16 Tani Trupi Gjykues dëshiron të shqyrtojë me Mbrojtjet
17 përkatëse hapat e mëtejshme lidhur me mbylljen e çështjes së
18 tyre. Dëshmitari 1DW-007 e mbaroi dëshminë dje, pra, në 18
19 nëntor 2025 dhe ishte i fundit dëshmitar i Mbrojtjes së
20 Thaçit. Bazuar në këtë, Mbrojtja [Sipas përkthimit] dëshiron
21 të konfirmojë me dy Mbrojtjet, Thaçit dhe Krasniqit, nëse janë
22 dakord, janë gati ta mbyllin këtë çështje.

23 Duke qenë se nuk ka dëshmitarë të tjerë dhe nëse ka
24 ndonjë mocion tjetër për të paraqitur lidhur me pranimin e
25 provave. Nëse ka dhe mocione të tjera për t'u paraqitur që do

1 të ishin me dobi për Mbrojtjen për të vënë në dukje se kur
2 mendohet se mund t'i paraqesin këto mocione.

3 Z. Misetic.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Hë për hë nuk kemi dëshmitarë
5 shtesë, por kemi mocion në bazë të rregullit 153 dhe bazuar në
6 të mbase mund të duam të thërresim dëshmitarë shtesë në bazë
7 të rregullit 153.

8 Për sa i takon dëshmime me shkrim nuk parashikojmë të
9 ofrojmë dëshmi shtete. Megjithatë, duam të kemi mundësinë të
10 shqyrtojmë atë që na kanë mbetur nga lista e provave
11 materiale. Në qoftë se diçka do të ishte më pak se një grusht,
12 të themi, provash materiale, do t'i kontaktojmë palët e tjera
13 për të parë nëse mund të biem dakord dhe pastaj do të mund të
14 paraqesim një mocion në bazë të urdhrit të Trupit Gjykues që
15 do të duhet të demonstrojmë arsyet bindëse për mocion shtesë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo mjafton.
17 Mund t'ju them se ne planifikojmë për mbylljen, për datën e
18 mbylljes rreth dy javë, pas dy javësh. Pra keni kohë të
19 mjaftueshme. Ne synojmë që të marrim -- që pyetjet t'i marrim
20 me përgjigje me shkrim deri në 1 dhjetor. Sa për t'ju dhënë
21 një ide.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, në përgjigje të pyetjes kur
23 jeni gati ta mbyllni, në qoftë se ka mocion jогоjor, ne mundet
24 ta mbyllim. I vetmi problem që kemi ka bërë vetëm me W04752,
25 që mund të na pengojmë ta mbyllim çështjen.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk parashikojmë ndonjë gjë. Mbase
2 do të na duhet një apo dy ditë për t'ju dhënë listën e provave
3 dhe ta konfirmojmë atë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju e dëgjuat
5 atë që thashë. Keni një javë për ta marrë vendimin me qëllim
6 që pastaj dhe ne të veprojmë në bazë të tij.

7 Ka ZPS-ja apo Mbrojtësi i Viktimave ndonjë gjë për të
8 thënë lidhur me këtë? Jo, nuk ka.

9 Duke marrë parasysh parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e
10 Thaçit, Krasniqit mendoj që jeni -- keni mundësi të jepni një
11 datë se kur mendoni që të mbyllet çështja.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të them mbas zgjidhjes së
13 çështjes së W04752. Në qoftë se na del që duhet ta thërresim
14 të dëshmojë drejtpërdrejtë, atëherë do ta bëjmë një gjë të
15 tillë. Në qoftë se ka një vendim për mocionin tonë atëherë e
16 mbyllim menjëherë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Ellis.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Për ne afati është ai që u përmend,
20 pra mbas një jave.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është e
22 mjaftueshme.

23 Trupi Gjykses do të kalojë në një pikë tjetër. Paneli i
24 Trupit Gjykses vëren se lidhur me raportin e fundit për faktet
25 e rëna dakord që u paraqitën nga ZPS-ja në 13 shtator 2024.

1 Trupi Gjykses kërkon konfirmim nga palët dhe
2 pjesëmarrësit në qoftë se ka ndonjë çështje të mbetur apo që
3 pritët të zgjidhet, diskutim midis palëve lidhur me faktet e
4 rëna dakord dhe nëse F02573 është në fakt raporti i fundit i
5 synuar.

6 Po fillojmë me ZPS-në.

7 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi mesa dimë ndonjë bisedë që
8 pritët të bëhet dhe po, ne konfirmojmë se F02573 është raporti
9 i fundit për këtë çështje.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe ne biem dakord.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lidhur me
13 transkriptin, klasifikimin e transkriptit, Trupi Gjykses vëren
14 se ka një numër transkriptesh me kërkesa për riklasifikim që
15 presin. Duam të dëgjojmë nga palët dhe pjesëmarrësit në qoftë
16 se ka ndonjë kundërshtim me mbylljen e procedurës së
17 paraqitjes së provave kur kërkesat për riklasifikim janë akoma
18 të pavendosura.

19 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk kemi kundërshtim.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] As ne nuk kemi, por kam diçka për
21 të shtuar dhe më mirë ta bëj tani.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne duhet të
24 vëmë në dijeni Tribunalin se, për fat të keq, në bazë të
25 urdhrit të mëparshëm të këtij Trupi Gjykses për të bërë

1 redaktimet publike, për fat të keq, përpara datës 13 shtator
2 [Sipas përkthimit] nuk e kemi bërë.

3 Ndërsa pjesa më e madhe ka qenë në seancë publike,
4 gjithsesi nuk parashikojmë ndonjë redaktim të madh të
5 transkriptit. Prandaj do të donim të na jepnit një javë më
6 shumë që t'i kthehemi transkripteve të shtatorit që ta bëjmë
7 këtë gjë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një javë
9 mjafton?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Mjafton.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
16 -- meqenëse Trupi Gjykses nuk do të thërrasë provë në bazë të
17 rregullores, Trupi Gjykses kërkon nëse ZPS-ja mund të na
18 tregojë nëse kërkon leje për të paraqitur kundërprova dhe nëse
19 Mbrojtja mund të na tregojë nëse ajo po ashtu kërkon -- do të
20 kërkojë leje për të paraqitur kundërprova.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, I nderuar Gjykatës.
22 Mbase kemi shqyrtuar standardet e zbatueshme sipas rregullit
23 133 dhe jurisprudencën e Gjykatës për këtë çështje dhe në bazë
24 të faktit se vendimet për pranimin e provave, siç e keni vënë
25 në dukje vetë, janë akoma të pavendosura, nuk ka ndonjë vendim

1 përfundimtar nga Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit dhe se ata
2 do të paraqiten ndonjë mocion tjetër, kemi mësuar, pra, se kjo
3 gjë do të bëhet javën që vjen. Sigurisht siç mund të pritet
4 nëse paraqesim apo jo ndonjë mocion varet nga rezultati i
5 kërkesës së Mbrojtjes që nuk është vendosur akoma për pranimin
6 e provave. Megjithatë, në këtë fazë mund të themi se rregull -
7 - në bazë të -- çdo kërkesë në bazë të rregullit 138 do të
8 jetë e kufizuar në fushëveprim.

9 Për sa i takon kohës, ne parashikojmë që do të jemi në
10 gjendje të bëjmë një kërkesë apo t'ju njoftojmë se nuk do të
11 bëjmë kërkesë brenda një jave të çdo vendimi përfundimtar
12 lidhur me pranimin e dëshmive të paraqitura nga Mbrojtja.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të them vetëm se sigurisht
14 nuk u themi dot në këtë moment nëse do të paraqesim
15 kundërprova pa parë se çfarë provash do të paraqiten si
16 kundërprova.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne presim që
18 ta keni këtë vendim gati, që kur ne të vendosim, ju të keni
19 përgjigjet, të marrim përgjigjen. Me fjalë të tjera mund të
20 jetë pas një jave dhe ju të jeni gati t'i përgjigjeni
21 menjëherë

22 Z. PACE: [Përkthim] Po, kjo sigurisht varet nga çfarë
23 keni parasysh menjëherë sepse kërkesa jonë për kundërprova
24 varet nga vendimi juaj. Ne kemi gjëra në mendje, po e pranoni
25 këtë, do të bëjmë këtë, e kështu me radhë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më 1 dhjetor
2 duhet të jeni të gatshëm të përgjigjeni.

3 Z. PACE: [Përkthim] Është një afat shumë i ngushtë por ne
4 do të kërkojmë zgjatje të kohës në qoftë se do të jetë e
5 nevojshme.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në këtë kohë
7 çdo gjë do të bëhet me afate të shkurtra prandaj bëhuni gati.

8 Tani do të kalojmë te mbyllja e procedurës së paraqitjes
9 së provave.

10 Trupi Gjykses parashikon dhënien e vendimit për të gjitha
11 vendimet që kanë të bëjmë me pranimin e provës më apo rreth 1
12 dhjetorit. Trupi Gjykses dëshiron të kërkojë ndonjë -- ka
13 ndonjë çështje tjetër që palët dhe pjesëmarrësit parashikojnë,
14 dhe ju kërkoj përgjigje menjëherë. Dua përgjigje jo sa për të
15 kaluar radhën, por një përgjigje të drejtpërdrejtë.

16 Ka ndonjë çështje që palët dhe pjesëmarrësit parashikojnë
17 që do ta pengonte Trupin Gjykses për ta mbyllur procesin e
18 paraqitjes së provave më apo rreth 4 dhjetorit? Dhe përveç
19 kësaj, palët dhe pjesëmarrësit kanë ndonjë kundërshtim që
20 Trupi Gjykses t'i mbyllë procedurat e paraqitjes së provave me
21 shkrim dhe jo në seancë dëgjimore?

22 Z. PACE: [Përkthim] Për sa i takon mbylljes së provave me
23 shkrim nuk kemi kundërshtim. Dhe nëse Mbrojtja do të paraqesë
24 apo jo mocione të tjera që do ta mësojmë javës tjetër, nuk
25 dimë gjë tjetër.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk parashikojmë ndonjë mocion nga
2 Mbrojtja, mocion shtesë që do të pengojnë të mbyllni çështjen.
3 Në qoftë se ne parashikojmë diçka jogojore kjo nuk do t'ju
4 pengojë për ta mbyllur.

5 Mocioni në bazë të rregullit 153 që është -- nuk është
6 vendosur akoma. Do të vendoset përpara 4 dhjetorit.

7 Për sa i takon provave të kundërprovave unë nuk shikoj të
8 ketë ndonjë çështje, ndonjë problem për ju.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, nuk keni
10 ndonjë problem që t'i bëni këto me shkrim?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ta
13 mbyllim me shkrim?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Ne nuk kemi ndonjë problem për këtë.
15 Nuk është se do të marrim ndonjë hap. Pati një parashtrim të
16 Zyrës Administrative që ishte konfidencial lidhur me një
17 kërkesë bërë një shteti të tretë për një kërkesë për ndihmë,
18 pra, kur një raport u -- është bërë një raport për
19 mosbashkëpunim. Ne nuk do të ndërmarrim ndonjë veprim tjetër
20 sepse duket sikur çështja është vendosur, por po të dali
21 ndonjë gjë nga ju do ta kemi parasysh.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo nuk kemi ndonjë kundërshtim për
25 t'u bërë njoftimi me shkrim.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne mbështesim mbylljen me shkrim,
2 nuk kemi asnjë problem për të ngritur përtej atyre që u ngiten
3 tani.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws,
5 çfarë keni për të thënë?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Kemi një parashtrim për të dorëzuar.
7 Nuk është me doemos për provat, por menduar që është e
8 përshtatme thjesht për t'ju informuar se do të dorëzoj një
9 parashtrim të protokolluar i cili ka të bëjë me objektin e
10 pranimi të provave lidhur me viktimat në këtë çështje
11 gjyqësore.

12 Këtë parashtrim nuk mund ta dorëzojmë pa pasur fillimisht
13 një vendim lidhur me rishqyrtimin sa i takon kërkesës tonë
14 sipas rregullës 153, por shumë shpejt pas daljes së këtij
15 vendimi do ta bëjmë këtë parashtrim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Do të kalojmë tani tek pika e fundit e rendit të ditës
18 sot, të paktën me aq sa kam unë këtu përpara.

19 Me 13 tetor 2025, pas konsultime mes palëve -- me palët
20 dhe pjesëmarrësit, Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të dorëzohen
21 dosjet përfundimtare gjyqësore të palëve më 30 janar 2026, ose
22 60 ditë pas mbylljes së procedurës së paraqitjes së provave,
23 cilado qoftë më e mëpasmja. Dhe e dyta, ka vërejtur se
24 megjithatë Mbrojtësi i Viktimave nuk i është bashkuar kësaj
25 kërkesë, ai nuk ka kundërshtuar një propozim të arsyeshëm për

1 një afat të ri i cili nuk cenon mbylljen e përsheptuar të
2 kësaj procedure.

3 Tani që dëshmitari i fundit i Mbrojtjes ka dëshmuar, ka
4 përfunduar, dhe duke pasur parasysh dhe parashtrimet që kemi
5 dëgjuar gjatë kësaj Konference për Ecurinë e Çështjes, Trupi
6 Gjykues dëshiron që palët dhe pjesëmarrësit të shprehen se kur
7 parashikojnë se mund të dorëzojnë dosjet përfundimtare
8 gjyqësore apo deklaratën mbi pasojat, sipas rastit.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, siç e kemi parashikuar është
10 kërkuar afati 30 janar 2026 apo 60 ditë pas mbylljes së
11 procedurës së paraqitjes së provave, cilado qoftë më e
12 mëvonshmja. Kjo kërkesë e përbashkët është e arsyeshme.

13 Gjatë të gjithë procesit gjyqësor janë pranuar provat dhe
14 janë zgjidhur problemet, duke pasur parasysh faktin se palët
15 dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësinë që të bëjnë parashtrime
16 mbi peshën përfundimtare dhe të paraqitjes së provave të tyre
17 në përfundim të procesit gjyqësor. Dosjet përfundimtare e
18 japin këtë mundësi. Dhe është një fazë e rëndësishme e
19 procesit gjyqësor, sidomos në rrethanat e një çështje
20 gjyqësore si kjo.

21 Duke qenë se palët dhe pjesëmarrësit duhet të kenë punuar
22 në këto dosje përfundimtare gjatë të gjithë procesit gjyqësor,
23 duhet parashikuar një kohë e konsiderueshme për përpunimin
24 përfundimtar dhe dorëzimin e këtyre dosjeve përfundimtare
25 gjyqësore. Sigurisht kjo merr parasysh faktin që të gjitha

1 provat nuk mund të analizohen plotësisht pa përfunduar
2 procedura e paraqitjes së provave.

3 Siç u tha edhe nga Trupi Gjykues do të ketë një farë kohe
4 që të do të lejohet, kjo vjen nga transkripti i datës 19
5 shkurt.

6 Natyra e arsyeshme e kërkesës që është dorëzuar nga të
7 gjitha palët dhe pjesëmarrësit përbën dëshmi e faktit se në
8 çështje të tjera gjyqësore që janë dëgjuar nga kjo Gjykatë, në
9 dy prej këtyre çështjeve gjyqësore, palëve ju janë dhënë 30
10 ditë si minimum, që parashikohet nga rregullorja, ndërsa një
11 tjetër çështje gjyqësore 45 ditë.

12 Mes faktorëve të tjerë dëshmitë -- më falni, faktorë të
13 tjerë të cilët dëshmojnë natyrën e arsyeshme të kërkesës së
14 përbashkët është periudha kohore që mbulon aktakuza që është
15 një vit e gjysëm; dhjetë pikat e akuzat për krime lufte dhe
16 krime kundër njerëzimit të cilat mbulojnë territorin e Kosovës
17 dhe pjesë të territorit të Shqipërisë mbi 400 incidente të
18 pretenduara; dëshmi mbi 250 dëshmitarë janë dëgjuar; mbi 5000
19 materiale provash janë pranuar në provat; dhe vendime mbi 300
20 pika të cilat janë paraqitur për t'u pranuar, të cilat ende
21 nuk janë marrë.

22 Duke marrë parasysh të gjitha këto, e dimë që Mbrojtja ka
23 edhe një javë për të informuar Trupin Gjykues nëse do të ketë
24 kërkesa të tjera për bërë, dhe mësuam dje për synimin nga ana
25 e Trupit Gjykues për të zgjidhur dhe vendimet që pritet të

1 merren deri më datë 1 dhjetor.

2 Duke pasur parasysh që data 1 dhjetor do të përbëjë
3 gjithashtu edhe -- do të marrë parasysh edhe faktin që ndonjë
4 palë mund të kërkojë leje për të apeluar ndonjë vendim apo jo
5 që do të merret deri atëherë. Megjithatë unë e ripërsëris
6 kërkesën tonë, të shohim se si do të shkojë kjo kërkesë lidhur
7 me zgjatjen e afatit njëditor që ju na latë sot.

8 Këtu dua që të përmend dhe synimin e Trupit Gjykses të
9 bërë të ditur më 2 shtator të këtij viti lidhur me vendosjen e
10 një afati që dosjet përfundimtare të dorëzoheshin përpara
11 pushimit dimëror të Gjykatës që do të ishte e premtja, 19
12 shkurt, dhe kjo është e pamundshme tani.

13 ZPS-ja ka thirrur mbi 120 dëshmitarë, dëshmitarë të cilët
14 janë dëgjuar nga prilli 2023 deri prill 2025. Mbrojtësi i
15 Viktimave ka hapur [çështjen] në korrik 2025 gjithashtu, pra
16 është një përudhë shumë e gjatë. Sa i takon datës ambicioze të
17 synuar të paraqitjes së provave nga ZPS-ja kjo është
18 përmbushur, dhe i kemi fokusuar të gjitha burimet që t'i
19 përgjigjemi kërkesave sipas rregullës 130 të përgatitjes për
20 paraqitjen e provave nga Mbrojtësi i Viktimave, pastaj dhe nga
21 ekipet e Mbrojtjes. Ne kemi përgatitur për t'ju bërë dhe
22 kundërpjetje dëshmitarëve nga na jonë, pra, dëshmitarëve të
23 palëve kundërshtare. Po kështu, kjo ka kërkuar nga ana jonë që
24 të bëjmë përgatitje edhe për paraqitjen e provave nga ekipet e
25 Mbrojtjes që na është dashur për këtë që t'i kushtojmë burime

1 të mëdha shqyrtimit të dokumenteve dhe këto materiale të cilat
2 janë mbi 300 të tilla.

3 Unë vërej se Trupi Gjykses, sigurisht besoj e kuptoj që
4 dhënia e një afati të caktuar palëve në përmbushje të kërkesës
5 së përbashkët është në interes të drejtësisë, përfshirë këtu
6 dhe interesin e viktimave të krimeve të pretenduara, si edhe
7 në ndihmë të Trupit Gjykses sa i takon kuvendimit përfundimtar
8 të tyre.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky është një propozim i
10 përbashkët, kështu që edhe unë i bashkohem shumë argumenteve
11 që u dhanë këtu. Por, sa i takon Mbrojtjes së ekipit së z.
12 Thaçi ne kemi punuar në mënyrë intensive për paraqitjen e
13 provave nga Mbrojtja, por është e pamundur që ne t'i kushtojmë
14 burime të mjaftueshme për të ndihmuar të akuzuarit që të
15 vlerësojnë mbi 25.000 faqe transkript, po kështu dhe mbi
16 11.500 materiale provash të veçanta që janë pranuar dhe edhe
17 ju, siç e thatë, pra, si Trup Gjykses në mënyrë të përsëritur
18 e keni thënë që akuzuarit do të duhej të kishin kohë për të
19 komentuar sa i takon peshës që i duhet dhënë këtyre provave në
20 momentin e duhur. Dhe unë ju parashtroj se të akuzuarit nuk do
21 të kenë kohë të mjaftueshme për të komentuar për peshën e
22 provave, sidomos sa i takon ekipit Mbrojtës të Thaçit nëse ne
23 do të kishim dy deri në tri javë pas mbylljes së fazës së
24 paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore.

25 Prandaj unë do të kërkoja që afati të ishte 30 janari.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
2 Z. Dixon.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Palët kanë shpenzuar shumë kohë me
4 diskutimet e tyre sa i takon kësaj kërkesë të përbashkët dhe
5 afatit të kërkuar. Këto kanë qenë diskutime të hapura për të
6 parë se cili do të ishte një propozim i arsyeshëm për ju, për
7 t'jua paraqitur juve, prandaj dhe ne e mbështesim këtë.

8 Ju bëj jehonë fjalëve të Trupit Gjykues kur kemi
9 diskutuar pak më përpara nëse ne do të kishim apo jo më shumë
10 se dhjetë javë.

11 Kjo do të ishte më shumë një periudhë orientuese, por
12 tani mbas dy vitesh procesi gjyqësor do të ishte mirë të
13 kishim kohën e mjaftueshme për të parë gjithë këtë larmi dhe
14 numër të madh materialesh dhe provash, dokumentesh që janë me
15 mijëra e mijëra faqe. Kjo kërkon shumë kohë.

16 Prandaj ritheksojmë që është bërë në mënyrë të përbashkët
17 ta shikoni nga ky këndvështrim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Dixon.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht rrezikoj të përsëris ato
21 që u thanë. Ne kemi rënë dakord si Mbrojtje dhe me Prokurorinë
22 në këtë proces ku jo gjithmonë jemi pajtuar mes nesh, pra,
23 fakti që jemi pajtuar për këtë do të thotë është e nevojshme,
24 është një proces gjyqësor shumë i gjatë, kompleks dhe i
25 ndërlikuar me shumë materiale. Na duhet koha e mjaftueshme për

1 të bërë parashtime efektive për të ndihmuar Trupin Gjykses
2 për të marrë një vendim.

3 Sigurisht ne nuk kemi paraqitur këtu prova por na
4 kërkohet që të shqyrtojmë provat që kanë paraqitur ekipet e
5 tjera të Mbrojtjes, kështu që na duhet një periudhë e
6 mjaftueshme kohore për t'u fokusuar në këto përgatitje.

7 E thashë më përpara që afati i propozuar për të cilin
8 kemi rënë dakord është krejtësisht i arsyeshëm në këto
9 rrethana.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 z. Ellis.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë nuk propozoj të përsëris
13 propozimet që u bënë këtu. Pajtohem tërësisht me to dhe i
14 mbështesim, kështu që një pjesë e mirë e materiale tona do të
15 na duhet që t'i përkthejmë për z. Krasniqi për të marrë
16 udhëzime sigurisht prej tij, dhe kështu që kjo kërkon kohën e
17 vet. Ta mbani parasysh këtë, ju lutem.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, z.
19 Laws ju harrova juve.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Për procesverbalin,
21 them se i konsiderojmë kërkesat e bëra emër të palëve si
22 kërkesa të arsyeshme dhe nuk jemi kundër tyre.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
24 vëren se, më 17 nëntor 2025, palët dhe pjesëmarrësit kërkuar
25 një shtyrje -- një zgjatje, më falni, të numrit të fjalëve për

1 dosjet përfundimtare gjyqësore dhe për deklaratën mbi pasojat
2 të Mbrojtësit të Viktimave.

3 Palët kanë kërkuar që ZPS-së t'i jepen 180.000 fjalë,
4 ekipeve të Mbrojtjes 90.000 fjalë secilës përgjigje nga dosjet
5 përfundimtare, ndërsa Mbrojtësi i Viktimave ka kërkuar që t'i
6 lejohen 90.000 fjalë për deklaratën mbi pasojat.

7 Në këtë aspekt, Trupi Gjykses thekson se dosjet
8 përfundimtare të palëve duhet që të fokusohen në çështjet më
9 kryesore faktike dhe problemet për të cilat palët nuk
10 pajtohen, dhe të mos diskutojnë gjëra të cilat janë të
11 parëndësishme apo që nuk lidhen me këto gjëra, siç është për
12 shembull, historia, krimet serbe, diskutimi i aspekteve për të
13 cilat janë marrë tashmë vendime, pra, shpjegime të zgjatura.
14 Dosjet përfundimtare nuk duhet që të trajtojnë çështje që kanë
15 të bëjnë me zhdëmtimet e mundshme.

16 Palët kanë diçka për të thënë?

17 Z. PACE: [Përkthim] Duke pasur parasysh që ka një lloj
18 mbivendosje midis arsyeve, unë do të doja të thosha që sa i
19 takon dosjes paraprake ne kishim diçka më pak se 90.000 fjalë.
20 Mirëpo kanë ndodhur shumë gjëra që prej dorëzimit të kësaj
21 dosjeje dhe kemi edhe shumë parashtime të tjera për t'u bërë.
22 Numri i fjalëve nuk është në asnjë mënyrë tregues i cilësisë,
23 por është një kërkesë nga ana jonë që të kemi 180.000 fjalë si
24 maksimum, dhe jo 90.000 [Sipas përkthimit] fjalë. Kjo është e
25 justifikuar duke pasur parasysh edhe barrën e provën e provës

1 që bie mbi ne, dhe për faktorë të tjerë që kanë të bëjnë me
2 këtë çështje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
4 z. Pace.

5 Ekipet të tjera të Mbrojtjes?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Asgjë për t'u shtuar.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Asgjë për t'u shtuar përveç faktit
8 që jemi pajtuar se është një vlerësim realist që sigurisht t'u
9 mbahemi çështjeve qendrore, por e kërkojmë këtë zgjatje.

10 PËRKTHYESI: Avokatët e tjerë nuk kanë gjë për të shtuar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta mbajmë
12 parasysh këtë dhe do të përpiqmi që ta marrim këtë vendim
13 brenda të premtës.

14 Z. LAWS: [Përkthim] Do të doja që të thosha, ka 155
15 viktimat pjesëmarrëse në proces. Duke pasur parasysh që
16 deklarata mbi rrjedhojat mbulon dhe çështje juridike dhe
17 çështje të tjera, ndërsa për çdo viktimë është 100 apo 200
18 fjalë. Thjesht kjo është arsyeja pse e kemi kërkuar këtë numër
19 fjalë për këtë deklaratë.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, nga 1.500 [Sipas
21 përkthimit] që janë pranuar në provat gjyqësore, për çfarë e
22 keni fjalën këtu, sepse numri i provave materiale është goxha
23 më i vogël se kaq.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt është në të gjitha gjuhët,
25 pra, prandaj dhe shkon në këtë shifër.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në fakt, shifra e vërtetë,
2 nëse mund ta them këtë, është një e treta e kësaj. Besoj se e
3 pranoi këtë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e kam llogaritur.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është nga një
6 e treta deri te një e dyta.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kështu.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, janë në të gjitha
9 gjuhët përkatëse.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Po kështu ka edhe prova materiale të
11 cilat janë pranuar në disa pjesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, janë
13 provat gjyqësore komplekse.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, për ta thënë shkurt, dy javë e
15 gjysmë që t'i shqyrtojmë të gjitha këto është një kohë e cila
16 është e pamjaftueshme.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Megjenëse jeni më këmbë, z.
18 Misetic, më duhet të them se jam paksa i shqetësuar lidhur me
19 disa prej parashtrimeve që kam dëgjuar. Nuk e di a e kam
20 kuptuar siç duhet që puna për dosjen gjyqësore nuk ka filluar
21 nga askush.

22 Na është dashur që të shpenzojmë 20 ditë në Gjykatë që
23 prej mesit të prillit të këtij viti. Pra, në seancë kemi qenë
24 20 ditë. Puna për dosjet gjyqësore duhet të ketë filluar para
25 shumë kohësh dhe besoj nuk jeni -- nuk është se do e filloni

1 tani.

2 Ju lutem na jepni një lloj sigurie lidhur me këtë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi kohë që kemi filluar të
4 punojmë për këtë, dhe unë po flas vetëm për ekipin tim. Por
5 ndërkohë kemi punuar shumë edhe mbi kalendarin e përshpejtuar
6 i cili është kërkuar nga Trupi Gjykses dhe kjo na ka marrë një
7 sasi të konsiderueshme burimesh.

8 Disa anëtarë të ekipit, por jo unë, janë marrë me dosjen
9 përfundimtare, ngaqë unë në fakt kam punuar për paraqitjen e
10 provave, por dhe na është -- është dhe dosja, më falni, është
11 dhe Çështja numër 12, duhet ta marrim parasysh edhe këtë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni të drejtë, pra, që ju
13 keni kërkuar -- duhet të kishim pyetur dhe ekipet e tjera. Nuk
14 e dimë nëse mund t'i pyesim.

15 Z. Dixon, ju çfarë keni për të thënë për këtë

16 Z. DIXON: [Përkthim] Po, mund ta merrni si të mirëqenë që
17 tashmë u bë kohë që kemi filluar të punojmë lidhur me këto
18 dosje, por kjo ka ndodhur paralelisht edhe me përgatitjen për
19 dëshmitarët e Mbrojtjes, edhe pse nuk na është dashur ne që
20 t'i thërrasim ata, nuk i kemi thirrur ne këta dëshmitarë, por
21 na është dashur që të merremi me provat dhe dëshmitë e
22 paraqitura përmes tyre, pra na është dashur të përgatitemi për
23 ata.

24 Pra, sigurisht që kemi disa muaj që po punojmë për dosjen
25 përfundimtare, por kjo është bërë paralelisht edhe me punë të

1 tjera. Por, na duhet që të sigurohemi që këto dosje
2 përfundimtare të jenë -- të përgatiten sa më mirë në interes
3 të drejtësisë dhe të akuzuarve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokati
5 Roberts.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për t'ju përgjigjur Gjyqtarit
7 Mettraux, ne po punojmë, ka disa kohë që punojmë për këto
8 dosje krahas punëve të tjera.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, puna ka filluar për dosjet
11 përfundimtare duke pasur parasysh që të jemi gati, por nuk
12 besojmë se ne mund ta përmbushim afatin e vendosur
13 paraprakisht nga Trupi Gjykses, pra, afati para Krishtlindjes.
14 Prandaj dhe ne kemi marrë pjesë në propozimin e përbashkët për
15 afatin e ri.

16 Unë e di se deri ku kemi arritur, po kemi ende punë për
17 të bërë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na sigurojë dhe
19 Prokuroria që kanë filluar të punojnë për dosjen?

20 Z. PACE: [Përkthim] Po, është e vërtetë. Ne e pranojmë që
21 vetëm 20 ditë kemi pasur seancë në sallë, por kjo nuk është --
22 që prej mesit të prillit, po kjo nuk është se e tregon shumë
23 drejtë situatën sepse sigurisht për këto 20 ditë na është
24 dashur të punojmë shumë ditë të tjera, prandaj dhe po kërkojmë
25 këtë afat 60 ditor pas mbylljes së procedurës së paraqitjes së

1 provave për të siguruar cilësinë që shpresojmë të ofrojmë, që
2 është e domosdoshme.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni
4 diçka për të shtuar?

5 Z. LAWS: [Përkthim] Po, kemi filluar dhe ne të punojmë
6 për deklaratën mbi pasojat.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Jemi informuar nga Çështja 12 që
8 Gjykatësi i vetëm synon që të fillojë gjykimin në dhjetor, më
9 datë 15 dhjetor, e cila do të ndikojë sigurisht në mënyrën
10 tonë për të paraqitur dhe dorëzuar dosjen përfundimtare.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju
12 kuptova.

13 Në fund, sipas rregullës 135, Trupi Gjykses dëshiron që
14 të pyesë palët dhe pjesëmarrësit nëse mund të bëjnë të ditur
15 sa të gjata do t'i kenë deklaratat përmbyllëse, dhe nëse do të
16 ishin në gjendje që të bënin deklaratat të tilla.

17 Palët dhe pjesëmarrësit çfarë mund të thonë për këtë në
18 mënyrë që dhe ne të mund të bllokojmë ditët përkatëse, të
19 rezervojmë, pra, sallën për këto deklaratat përmbyllëse sepse
20 si u tha, mund të ketë dhe një proces tjetër.

21 Çfarë mund të na thonë palët dhe pjesëmarrësit për këtë?

22 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Sigurisht kjo është
23 paraprake sipas rregullës 134 sa i takon deklaratave
24 përmbyllëse është 20 ditë pas dosjes përfundimtare. Duke pasur
25 parasysh kompleksitetit e kësaj çështje, siç e thashë më

1 përpara, dhe ajo që ka më shumë rëndësi, nëse ka pasur apo jo
2 përgjigje -- nëse do ketë apo jo përgjigje me shkrim, ne
3 propozojmë deklaratat përmbyllëse t'i mbajmë jo më vonë se 45
4 ditë nga dorëzimi i dosjes përfundimtare gjyqësore, nëse [E
5 padëgjueshme] duke pasur parasysh kjo është një minimale,
6 sigurisht kjo varet dhe nga një analizë e ngushtë e këtyre
7 dosjeve që ne do t'ju bëjmë në lidhje me deklaratat
8 përmbyllëse.

9 Çështjet e tjera në këtë Gjykatë nuk janë të krahasueshme
10 sa i takon kohëzgjatjes dhe afatit lidhur me këtë. Unë e di,
11 për shembull, që në çështjen kundër Mustafës ka pasur një
12 diferencë 60 ditore nga dorëzimi i dosjeve përfundimtare
13 gjyqësore tek deklaratat e përmbylljes.

14 Dhe siç e tha dhe avokati i z. Veseli, dhe i referohem
15 transkriptit të 19 shkurtit, edhe unë vetë e përmenda sot,
16 Kryegjykatësi, në fakt, më herët gjatë këtij viti e ka bërë të
17 ditur se palët do të kenë afat të arsyeshëm për të analizuar
18 dosjet përfundimtare përpara bërjes së deklaratave përmbyllëse
19 dhe sipas nesh, minimumi 45 ditë do të ishte një afat i
20 arsyeshëm për të.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni
22 diçka për të thënë me këtë?

23 Z. LAWS: [Përkthim] Ne mbështesim qëndrimin e
24 Prokurorisë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Qëndrimi jonë varet, lidhet me
2 datën e paraqitjes së dosjes përfundimtare. Në qoftë se na
3 jepet më shumë kohë për dorëzimin e dosjes përfundimtare nuk
4 angazhohemi për afatin 45 ditësh. Do të donim të jepej pak më
5 shumë, natyrisht kohë e mjaftueshme që të jemi në gjendje që
6 të shqyrtojmë, të analizojmë dosjen përfundimtare të
7 Prokurorisë dhe të jemi në gjendje që të përgjigjemi në mënyrë
8 të njëmendte me argumente gojore. Por në këtë pikë që jemi
9 mendoj që prioriteti, përparësia jonë është që të kemi kohë të
10 mjaftueshme për të bërë dhe dorëzuar dosjen përfundimtare.

11 Sa i takon sa kohë na duhet, do të kërkojmë për seancë --
12 do të kërkojmë një seancë të plotë për Mbrojtjen e Thaçit për
13 të paraqitur parashtrimet përfundimtare gojore.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 [Përkthim] Sa do të zgjasë kjo?

16 Z. PACE: [Përkthim] Është mirë që nuk erdhi nga unë ky
17 propozim sepse avokati ishte i pari, por në fakt në fakt ne
18 pajtohemi me atë që avokati i Mbrojtjes tha për Mbrojtjen. Ne
19 parashikojmë se Prokuroria do të ketë nevojë për dy ditë, pra
20 10 orë dhe secili ekip i Mbrojtjes, pastaj do të ketë një ditë
21 që i bie 5 orë.

22 Çështja tjetër për t'u marrë parasysh tradicionalisht,
23 dhe ne kërkojmë në këtë pikë, është hera, rasti, hera e fundit
24 pastaj kur palët do të shprehen. Mund të bëhet një pushim i
25 shkurtër i arsyeshëm që të na jepet mundësia neve të

1 kundërpërgjigjemi dhe pastaj do ju kërkojmë katër orë për neve
2 për parashtrimet përfundimtare dhe pastaj një orë për secilin
3 nga ekipet Mbrojtëse.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, z. Pace, sipas
5 kalendarit juaj, ne do të -- nuk do të jemi për -- nuk do të
6 bëjmë seancë për pesë muajt e ardhshëm, a është kështu,
7 përpara se të bëni ju parashtrime përfundimtare?

8 Z. PACE: [Përkthim] Pra, programi i përbashkët që është
9 propozuar për 60 ditë, paraqitja e dosjes përfundimtare na çon
10 në fillim të shkurtit nëse të gjitha vendimet merren në javën
11 e parë të dhjetorit. Dhe pas kësaj ne do të vazhdojmë me
12 propozimin e Mbrojtjes -- të ZPS-së për 45 ditë dhe do ta
13 shqyrtojmë atë. Nëse nuk gaboju, kjo na çon në mes të prillit,
14 mes të marsit afër marsit për deklaratat përmbyllëse.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, pesë muaj pak a
16 shumë.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pace, nuk mund t'ju pyes,
18 dosja përfundimtare e Prokurorisë është mjeti i Prokurorisë
19 për të bërë të gjitha, për të paraqitur të gjitha argumentet
20 përfundimtare, pra deklarata gojore përfundimtare do të jetë
21 thjesht e kufizuar në përgjigje ndaj pikave më të rëndësishme
22 për të cilat doni t'ju përgjigjeni Mbrojtjes, apo paraqitjes
23 së dosjes përfundimtare të Mbrojtjes.

24 Thjesht nuk e kuptoj se pse ju duhet kaq shumë kohë për
25 t'u përgatitur për deklaratën përfundimtare gojore ndërkohë që

1 keni dorëzuar një -- pasi të keni dorëzuar dosjen
2 përfundimtare të Prokurorisë që është e gjerë dhe e
3 hollësishme. A mund të na sqaroni pak më shumë lidhur me këtë?

4 Z. PACE: [Përkthim] Sigurisht. Mendoj që është e
5 rëndësishme të fillojmë nga ajo që fillojmë -- nga ajo që
6 garantohet nga rregullat, që është 21 ditë. 21 ditë. Dhe kjo
7 është zbatuar edhe në çështjet e tjera, siç e thashë, që janë
8 shumë më pak komplekse. Ne thjesht po kërkojmë dyfishin e
9 kësaj kohe.

10 Siç e përmenda më herët ne nuk do të paraqesim përgjigje
11 me shkrim ndaj dosjes përfundimtare të Mbrojtjes. E imagjinoni
12 që momentin e dorëzimit të dosjeve përfundimtare t'i shikojmë
13 ato, t'i analizojmë dhe kur them "rishikim" e kam -- që t'i
14 shohim -- nuk e kam fjalën që t'i shohim shpejt e shpejt apo
15 në mënyrë të përshpejtuar. Ne bëjmë të verifikojmë pohimet që
16 bëhen aty brenda, deklarimet dhe Mbrojtja do ta bëjë të
17 njëjtën gjë për dosjen tonë përfundimtare dhe është shumë mirë
18 që të bëhet kështu për të parë që ato që thuhet janë të sakta.
19 Pra, verifikimi i saktësisë nga -- i dosjes përfundimtare nga
20 njëra palë për palën tjetër merr kohë.

21 Dhe që paraqitja dhe organizimi, përpilimi i argumenteve
22 kërkon kohën. Ne nuk -- mund të mos na duhet dhjetë, siç
23 kërkoja për fjalën përfundimtare. Kjo është maksimumi që
24 kërkoja në këtë pikë, por sa i takon përgatitjes dhe asaj që
25 do bëjmë për të përmbushur detyrimet tona siç duhet, është një

1 -- afati kohor që dhashë, më duket realist dhe është në
2 përputhje me atë që është dhënë në rastet e tjera, në çështjet
3 për aq sa jemi në dijeni ne. Dhe rastin, në çështjen Mustafa
4 janë dhënë 60 ditë. Natyrisht që çdo çështje ka diferencat dhe
5 dallimet e saj, por kur marrim parasysh një çështje të kësaj
6 natyre që e kemi, parashtrimi jonë për 45 ditë është i
7 arsyeshëm.

8 Natyrisht gjërat mund të ndryshojnë vartësisht edhe nga
9 dosjet, përmbajtja e dosjeve përfundimtare dhe do të veprojmë
10 bazuar në këtë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, thjesht desha t'ju
13 informoj për një çështje personale. Kam një angazhim nga data
14 13 deri me 23 shkurt dhe lidhur me Çështjen 12. Por në qoftë
15 se ka diçka që mund të -- që bëhet me doemos nga Trupi Gjykses
16 atëherë do të riorganizoj axhendën time, punën time. Thjesht
17 desha t'ju informoj për këtë gjë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Që të jetë në
21 procesverbal, do t'ju informojmë të premtën lidhur me këtë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Qëndrimi jonë, siç është thënë edhe
23 nga z. Misetiç, është -- ka një kufi për -- në bazë të të
24 cilit ne po punojmë dhe pra, kjo është data kur mund të dalë
25 aktgjykimi dhe do të ishte e vështirë që të bëjmë ndryshe,

1 pra.

2 Natyrisht neve na duhet të kohë e mjaftueshme për t'iu
3 përgjigjur dosjes përfundimtare të Prokurorisë, por kjo varet
4 nga parashtrimet me shkrim. Dhe pastaj ne gjithashtu do të
5 kërkojmë një ditë për Mbrojtjen e z. Veseli që -- dhe një --
6 se të na jepet mundësia për t'u kundërpërgjigjur
7 kundërpërgjigjeve të mëpasshme siç lejojnë dhe rregullat.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ngjashëm edhe ne, pajtohem me
11 kolegët tanë. Gjithçka varet nga data e paraqitjes së dosjeve
12 përfundimtare por natyrisht qëndrimi jonë është i njëjti, ne
13 do të kërkojmë më shumë kohë sesa për argumentet
14 përfundimtare. Dhe ne do të kërkojmë një ditë për parashtrimet
15 tona që do të bëjmë. Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj që parashtrimet tona janë
18 shënuar. Pajtohem tërësisht me kolegët e mi të Mbrojtjes.
19 Është koha për dosjen përfundimtare që është -- koha që është
20 për dosjen përfundimtare është shqetësimi jonë kryesor për
21 momentin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem me kohën, pra, njëditore
24 për parashtrimet e Mbrojtjes.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Trupi Gjykues informon palët dhe pjesëmarrësit duke marrë
2 parasysh çështjet e diskutuara sot, Trupi Gjykues synon që të
3 nxjerrë një vendim me shkrim, siç e thashë, në fund të kësaj
4 jave, ku do të përcaktojë afatet kohore dhe do të japë
5 udhëzimet pjesëmarrësve dhe palëve lidhur me kohëzgjatjen e
6 dosjeve përfundimtare, dosjes gjyqësore përfundimtare dhe
7 deklaratës mbi pasojat; datën për parashtrimin e dosjes
8 përfundimtare; dhe çështje që ngelen të pazgjidhura.

9 Përpara se të përfundojmë sot dua të sigurohem.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dy çështje të shkurtra, z.
11 Kryetar, përveç në qoftë se ka Prokuroria diçka për të thënë.

12 Siç kemi njoftuar Trupin Gjykues më herët, përkthimi i
13 P189, P765.1, do kërkojmë kohë që t'i shtojmë për këto
14 përkthime. Pra, presim përkthimin zyrtar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
16 kundërshtim për këtë?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Në qoftë se pranohet
19 shtimi i përkthimit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shtimi do të
21 -- ky përkthim do të shtohet.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 Dhe pastaj çështja e dytë, siç kemi thënë të hënën, ne
24 kemi nxjerrë dje versionin e redaktuar publik të deklaratës të
25 Dëshmitarit të Gjeneralit Clark, dhe kemi kërkuar leje që ta

1 shtojmë këtë versionit të redaktuar publik të provës materiale
2 ekzistuese 1D430.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E njëjta
4 pyetje. Ka ndonjë kundërshtime?

5 Z. PACE: [Përkthim] jo.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E njëjta
7 përgjigje? Pranohet.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kaq kishim ne.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] z. Dixon.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Mendova që kishte një
11 pikë në axhendë sa i takon parashtrimeve mbi dënimin sepse ne
12 kemi bërë një kërkesë në parashtrimin tonë të të hënës lidhur
13 me atë që kjo të trajtohet pas aktgjykimit, në qoftë se ka
14 aktgjykim me shpallje -- varësish prej rregullës 162 dhe 164.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk kemi
16 synim që ta dënojmë atë përpara aktgjykimit.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Por është çështje për të cilën ne
18 duam të bëjmë parashtrime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Kërkesa jonë është që këto të bëhen
21 ndaras, pas aktgjykimit në qoftë se ka shpallje fajtor edhe ka
22 një dispozitë ligjore na mundëson që të bëjmë një kërkesë të
23 tillë, pra, dhe kjo është pjesë e parashtrimit që kemi
24 dorëzuar të hënën. Pra, do të kërkonim që të trajtohet sepse
25 kjo do të ndikojë në kohën dhe kohëzgjatjen, numrin e fjalëve

1 edhe të tjera. Kjo praktikë që është bërë në Gjykatën Penale
2 Ndërkombëtare dhe është edhe e [E pakuptueshme]. Do të kërkoj
3 që ky model të ndiqet dhe meqenëse nuk ka kundërshtime për
4 këtë sipas rregullave dhe kjo nuk pengohet, nuk ndalohet nga
5 rregullat.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë
7 kërkesën tuaj.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Një pikë, kisha një pikë, z.
10 Pace. Ndoshta nuk e kuptova, por Prokuroria nuk ka bërë
11 parashtime mbi dënimin që mund të vijë në parashtimin tuaj
12 të 17 nëntorit. Prokuroria e kundërshton kërkesën për këtë
13 gjë?

14 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk kemi bërë parashtime sepse
15 nuk mund të bëj tani që të shpreh tonë.

16 Prokuroria kupton që kjo është në përputhje me rregullën
17 159(6) dhe vendimet e mëparshme të kësaj Gjykate lidhur me
18 përcaktimin e dënimit në përgjithësi, përveçse në qoftë se ka
19 ndonjë arsye të jashtëzakonshme që duhet të trajtohet në
20 aktgjykimin, dhe procedura është ajo që përmendet.

21 Në fakt, rregulla 07 [Sipas përkthimit] të Rregullores e
22 bën të qartë se palët duhet të supozojnë se Trupi Gjykses do
23 të përcaktojë dënimin e duhur në të njëjtën kohë me shpalljen
24 e aktgjykimit, edhe ky është -- puna pastaj dhe përgjegjësi e
25 avokatëve të palëve dhe palëve për të -- që duhet të -- për të

1 planifikuar dhe për të paraqitur provat në gjykim, përfshirë
2 ato që janë relevante për aktgjykimin. Pra, parashtimi jonë
3 është që nuk ka arsye që të bëhen ndaras.

4 Në fakt, e di që një prej vendimeve të cilat po i përmend
5 në Çështjen 07, që është në 553, paragrafi 18, Trupi Gjykses
6 ka konstatuar se palët duhet të bëjnë ato parashtime në qoftë
7 se diçka ndryshon, Trupi Gjykses prapë se prapë mund të
8 vendosë të nxjerrë aktgjykimin dhe të japë udhëzime mbi hapat
9 a mëtejshëm sa i cakton përcaktimit të dënimit. Pra, që të
10 urdhërohem tani që të bëjmë parashtime për dënimin, nuk
11 është detyruese.

12 Siç e thashë, ne jemi të gatshëm dhe do të bëjmë siç na
13 urdhërohet, natyrisht.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush tjetër
15 ka diçka për të thënë lidhur me këtë pikë? Mesa duket jo.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk është lidhur me këtë në veçanti,
17 por përpara se të përbyllim mund të ngre një pikë si pjesë e
18 parashtimeve përbyllëse të Mbrojtje. Ne parashikojmë se z.
19 Krasniqi mund të dëshirojë të flasë gjatë parashtime
20 përbyllëse. Thjesht desha t'ju njoftoj lidhur me këtë pikë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
22 Supozoj se kjo vlen edhe për të tjerët.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Ndonjë çështje tjetër që ka mbetur pa u trajtuar?

1 Faleminderit të gjithëve. Ka qenë një punë e rëndësishme,
2 vlerësoj përpjekjet dhe punën e të gjithëve, kolegjalitetin e
3 të gjithëve. Dhe them që nuk -- edhe pse ndonjëherë ka patur
4 një nivel nervozizmi apo tension, por gjithçka ka qenë
5 interesante dhe një përvojë shumë pasuruese dhe vlerësoj
6 përpjekjet e të gjithëve. Ne e kemi bërë -- kemi ndoshta
7 mërzitur ndonjëherë dhe njëri-tjetrin, jam i sigurt për këtë,
8 dhe ndoshta kjo do të vazhdojë, por vlerësojmë punën që kemi
9 bërë së bashku dhe mendoj se është shumë e rëndësishme që i
10 kemi dhënë mundësi këtij numri kaq të madh të dëshmitarëve dhe
11 materialit që të dëgjohen dhe të pranohen në një kohë dhe një
12 mënyrë shumë efikase.

13 Faleminderit edhe një herë të gjithëve për përpjekjet
14 tuaja dhe unë e vlerësoj, jam i sigurt, këtë gjë, dhe
15 përpjekjet, ashtu siç i vlerësojnë edhe pjesëtarët e tjerë,
16 jam i sigurtë, të Trupit Gjykues.

17 Seanca ndërpritet.

18 --- Seanca mbyllet në orën 15.18